



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



12 Nr *400/01-9347* dt. *26/02* 2021

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, neni 34. pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja C të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2021, miraton këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim formohet Komisioni për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile i propozuar nga Kryetari i Komunës si vijon:

1. Lumnije Prenku – kryetar nga ekzekutivi
2. Enver Hoxha - anëtar nga ekzekutivi
3. Besart Bajrami - anëtar nga ekzekutivi
4. Petrit Sinani - anëtar nga kuvendi
5. Perparim Bajraktari - anëtar nga kuvendi
6. Florentina Elezi - anëtar nga kuvendi dhe
7. Eronita Brahimi - përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar,

Neni 2

Komisioni ka për detyrë të bëjë plotësim ndryshimit të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, duke e harmonizuar këtë rregullore me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Komisioni për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lart dhe përkushtim.

Neni 4

Komisioni për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, i dërgon Kuvendit të Komunës për aprovim këto ndryshime, pas përfundimit të gjitha procedurave të parapara me ligj.

Neni 5

Mandati i këtij komisioni vazhdon deri në aprovimin e këtyre ndryshimeve nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit si dhe nënshkrimi nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj